

## MENDIM PAKICE

Unë, komisioner Lulzim Hamitaj, si anëtar i trupit gjykues, nuk pajtohem me vendimin e marrë nga kolegët e shumicës për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, për shkak se subjekti i rivlerësimit, sipas mendimit të pakicës, arriti një nivel të besueshëm edhe në rivlerësimin e pasurisë, ndërsa, në lidhje me kriterin e figurës dhe të aftësive profesionale, si dhe me pikat e tjera (me përjashtim të pikave nr. 83 - 88<sup>1</sup>) të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, që nuk do të analizohen në vijim, bashkohem me mendimin e shumicës së trupit gjykues, të shprehur në vendim.

Unë, si anëtar në pakicë/kundër, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit duhej të ishte konfirmuar në detyrë, pasi ka arritur një nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë së familjes së tij – dhe ky fakt është konfirmuar edhe nga mendimi/vlerësimi i shumicës – si dhe ka provuar gjithashtu, (sipas pakicës) me dokumentacion ligjor dhe me shpjegime bindëse, mundësinë financiare të familjes së z. B. I., lidhur me pagesën e shumës prej 50.000 euro, për porositjen e apartamentit të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, kompleksi “\*\*\*\*”, Tiranë – të përdorur nga subjekti (pasi apartamenti në fjalë ishte porositur në vitin 2010 dhe kishte hyrë në zotërimin e babait të tij, z. B. I., përpara së subjekti të niste përdorimin).

Konkretisht, lidhur me një nga pikat që ka pasur mendim ndryshe – mbi disponibilitetin financiar të z. B. I. dhe të familjes së tij për të paguar në vitin 2010 shumën 50.000 euro – nga hetimi administrativ, i kryer nga Komisioni ka rezultuar, si vijon:

- i. Subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se banonte në një apartament të marrë me qira në Tiranë, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” (e njohur edhe Rr. “\*\*\*\*”), kompleksi “\*\*\*\*”, k. \*\*\*, ap. \*\*\* – i cili ishte porositur dhe marrë në dorëzim nga babai i tij, z. B. I., prej vitit 2010. Këtë adresë banimi subjekti e kishte deklaruar edhe më herët në deklaratat vjetore të pasurisë.
- ii. Lidhur me këtë marrëdhënie, subjekti i rivlerësimit ishte pyetur në vitin 2014 nga inspektorët e ILDKPKI-së, dhe sipas dokumentit “procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive” i mbajtur<sup>2</sup> në datën 30.10.2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, ka deklaruar se *prej vitit 2011 banonte në një apartament në Tiranë, të blerë nga prindërit e tij në vitin 2010, në Rr. “\*\*\*\*”. Ky apartament nuk ka qenë ende i pajisur me certifikatë pasurie nga ndërtuesi. Si burim të ardhurash për krijimin e kësaj pasurie nga babai i tij subjekti deklaroi edhe kontributin e dhënë nga vëllezërit e tjerë, F. dhe F. I. dhe e motra A. I. – duke përjashtuar ndonjë kontribut të vetin. Gjithashtu, subjekti, në këtë dëgjese ka specifikuar se, ndërsa vëllezërit e tjerë dhe e motra ishin ende në një certifikatë familjare dhe bashkanëtar të së njëjtës familje me prindërit, ai ishte shkëputur nga trangu familjar prej vitit 2007, kur ishte martuar.*
- iii. Në deklaratën noteriale<sup>3</sup> të datës 27.9.2016, z. B. I. është shprehur se *posedonte pasurinë e llojit apartament me sip. rreth 100 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë,*

---

<sup>1</sup> Pakica nuk pajtohet me mendimin e shumicës, të shprehur lidhur me analizimin, vlerësimin dhe konkluzionet e arritura nga kolegët mbi situatën faktiko-ligjore që i përkasin burimeve financiare të krijimit të pasurisë së përdorur nga subjekti (të përshkruara në f. 15-19, të vendimit nr. 220 të Komisionit, në pikat 83-88) – as me konkluzionet e shumicës mbi kriterin e pasurisë, të përshkruara pas pikës 162, në vijim të tabelës së analizës financiare (në paragrafin e parë të f. 36) – dhe as me qëndrimin e mbajtur në mendimin paralel.

<sup>2</sup> Dërguar në Komision me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 15.7.2019.

<sup>3</sup> Deklarata nr. \*\*\*.

*dhe se këtë pasuri ia jepte me qira subjektit të rivlerësimit për një afat 5-vjeçar, me çmim qiraje mujore 15.000 lekë.*

- iv. Përgjatë hetimit administrativ, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorëve, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *nga fillimi i vitit 2011 deri në nëntor të vitit 2017, ka jetuar me qira në adresën: Rr. “\*\*\*” (e njohur edhe me emrin “\*\*\*”), kompleksi “\*\*\*”, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*. Ky apartament ka qenë i porositur dhe mobiluar nga babai i subjektit, z. B. I. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se *vlera e qirasë së paguar për këtë apartament ka qenë 15.000 lekë/muaj dhe u është bërë me para në dorë prindërve të tij. Për shkak të marrëdhënies së posaçme të besimit me qiradhënësin për periudhën janar 2011 – shtator 2016 nuk është bërë kontratë e shkruar për marrëdhënien e qirasë.**
- v. Referuar kontratës<sup>4</sup> së porosisë për investim dhe dorëzim apartament banimi dhe vendparkimi të datës 23.9.2010, konstatohet se z. B. I. ka porositur nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., një apartament banimi më sip. 100 m<sup>2</sup> dhe një garazh, në total në vlerën 65.000 euro, në objektin që kjo shoqëri ndërtonte në Rr. “\*\*\*”, Tiranë. Sipas kontratës, shuma prej 50.000 euro është paguar ditën e lidhjes së kontratës dhe kësti i dytë dhe i fundit prej 15.000 euro do të paguhej me regjistrimin në hipotekë.
- vi. Nëpërmjet deklaratës noteriale<sup>5</sup> të datës 12.2.2019, z. B. I., përveç të tjerash, ka shpjeguar se si burim për krijimin e kësaj pasurie (ka paguar 50.000 euro në datën e porosisë) ka deklaruar edhe të ardhurat e fëmijëve të tij A., A., F. dhe F., si dhe të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar.
- vii. Lidhur me kërkesën e Komisionit që të vinte në dispozicion dokumentin e plotë të pronësisë për këtë apartament, subjekti ka shpjeguar se *ky apartament nuk ishte i regjistruar në ZVRPP (përgjatë gjithë kohës që babai e ka pasur këtë pasuri, derisa e ka shitur në vitin 2018) dhe, për rrjedhojë, babai i tij nuk ka pasur certifikatë pronësie.*
- viii. Për sa i përket pyetjes nëse është deklaruar apo jo marrëdhënia e qiramarrjes që ka pasur me babain për këtë apartament, subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar: “... *ai si përdorues dhe qiramarrës i këtij apartamenti nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor për të deklaruar këtë kontratë para autoriteteve publike, por sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.2008, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është detyrim i qiradhënësit, pra, subjektit, që realizon të ardhura nga dhënia me qira, që të paguajë tatimin mbi këto të ardhura”.*
- ix. Nga sa më sipër, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur apartamentin e babait të tij për disa vite dhe lidhur me kundërshtëpërblimin e pretenduar nuk është provuar me dokumentacion ligjor ekzistenca e marrëdhënies së qirasë para datës 27.9.2016, si dhe pagesat e kryera për qiranë deri në atë datë (ndonëse formalizimi dhe dokumentimi zyrtar asokohe nuk ka qenë detyrim për subjektin). Nuk mund të përjashtohet mundësia e ekzistencës së marrëdhënies (verbale) të qirasë – për sa kohë nuk ka pasur detyrim për hartimin e një kontrate të shkruar dhe të nënshkruar përpara noterit, sikurse nuk ka pasur detyrim për të kryer pagesat nëpërmjet transfertave bankare apo me mandatpagesa të nënshkruara nga palët (për më tepër, duke pasur parasysh marrëdhënien e veçantë fëmijë-prind, midis pronarit të sendit dhe përdoruesit të tij).
- x. Gjithsesi, nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ketë përdorur pasurinë e mësipërme dhe në mungesë të provës së marrëdhënies kontraktore të

---

<sup>4</sup> Kontratë nr. \*\*\*

<sup>5</sup> Deklaratë nr. \*\*\*.

pretenduar, Komisioni ka vlerësuar se referuar pikës 14, të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. B. I. (babai i subjektit) duhet të cilësohet dhe konsiderohet si një person tjetër i lidhur dhe, për rrjedhojë, për subjektin e rivlerësimit lind detyrimi për të justifikuar ligjshmërinë e burimit financiar që ka mundësuar krijimin e pasurisë së përdorur prej tij (subjektit).

- xi. Për sa më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat që kanë shërbyer si burim financiar për blerjen e pasurisë apartament banimi, me sip. 100 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” / “\*\*\*\*”, Tiranë, të porositur dhe marrë në dorëzim nga z. B. I. në vitin 2010 dhe të përdorur nga subjekti i rivlerësimit përgjatë viteve 2011 – 2017.
- xii. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, lidhur me përdorimin e apartamentit të babait në adresën: Rr. “\*\*\*\*”, kompleksi “\*\*\*\*”, ap. \*\*\*, Tiranë, së bashku me shpjegimet e tij, paraqiti deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 26.5.2019, të shtetasit B. I., i cili ka pohuar dhe konfirmuar faktin se *që prej muajit janar 2011 deri në vjeshtën e vitit 2017, Fatri Islamaj ka qëndruar me qira në apartamentin e tij.*
- xiii. Lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie të babait të tij, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar si më poshtë:
- a. *“Për sa i përket burimit të të ardhurave që i kanë shërbyer babait tim për të porositur me kontratë sipërmarrjeje këtë apartament në vitin 2010, janë shpjeguar hollësisht në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., datë 12.2.2019 (f. 1-2), të babait tim, B. I., si dhe në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., datë 12.2.2019, të shtetasit F. I. (si dhe provat shoqëruese të kësaj deklarate) të depozituara në Komision.*
- b. *Si dokumentacion provues që lidhet me këto shpjegime të dhëna nga babai im, B. I., për burimet financiare për blerjen e këtij apartamenti kam vënë në dispozicion edhe:*
- 1. Kontratë shitjeje kuotash si shitës F. I. (i cili jeton edhe sot në një familje me babain, B.) me nr. \*\*\* rep., datë 25.7.2006, ku F. ka përfituar vlerën prej 2.450.000 lekësh, lënë të atit, B..*
  - 2. Kontratë shitjeje kuotash si shitës F. I. (i cili jeton edhe sot në një familje me babain, B.) me nr. \*\*\* rep., datë 16.4.2007, ku F. ka përfituar vlerën 64.000 euro, duke ia lënë babait, B.. Gjithashtu, janë paraqitur si prova drejtuar Komisionit me e-mail të datës 12.2.2019 (si dhe në protokoll me datë 14.2.2019), lidhur me angazhimet tregtare të z. F. I. në Zvicër për periudhën para vitit 2010, si person fizik i regjistruar, dhe si ortak e administrator i shoqërisë tregtare ‘\*\*\*\*’ GmbH, (është dërguar ekstrakti nga faqja e internetit të zyrës përkatëse të shoqërisë tregtare) në Zyrih. Dokumenti tregon pagesën e sigurimeve shoqërore në shumën 249.874 CHF në Zvicër (kuptohet që të ardhurat kanë qenë shumëfishi i kësaj shume).*
- c. *Përveç provave të depozituara deri në datën 20.11.2019, kam siguruar edhe një vërtetim nr. extr. prot., datë 22.11.2019, nga shoqëria shtetërore ‘\*\*\*\*’ sh.a., ku djali i madh i B., A. I. (im vëlla) ka punuar. Duhet të mbani parasysh që unë kam qenë i shkëputur nga trangu familjar që në tetor të vitit 2007 kur jam martuar, ndërsa tre vëllezërit e tjerë kanë vazhduar të qëndrojnë me prindërit edhe për shumë vite. Edhe aktualisht jetojnë akoma në një shtëpi me prindërit dy vëllezërit, F. dhe F..*

- d. Sqaroj Komisionin se arsyeja përse po paraqes një vërtetim të ri të pagesës së vëllait, A., si provë, është se, pasi konstatoj se të ardhurat që ka marrë në shoqërinë '\*\*\*' sh.a. (ish-\*\*\* sh.a.) janë shumë më të larta sesa ato që reflektonin vërtetimet e Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore të paraqitura nga ana ime në datën 20.11.2019. Ky ndryshim mendoj që vjen për shkak se është paguar edhe me honorare dhe shpërblime të larta, të cilat nuk janë reflektuar në regjistrat e DRSSh-së, ku pasqyrohet paga bazë. Nga ky vërtetim i datës 22.11.2019 rezulton që vëllai i madh, A. I., është paguar me një pagë neto prej 15.821.961 lekësh nga viti 2000 deri në vitin 2010 dhe jetonte në një familje me prindërit. Ndërkohë, për tri vitet në vazhdim, 2011 – 2013, nga kjo shoqëri ka pasur vetëm rreth 11.310.507 lekë neto të ardhura.
- e. Sqaroj se në mbledhjen e këtyre shumave i kam zbritur tatimin, i cili përshkruhet për secilin vit në vërtetim, dhe kjo është vetëm paga neto. Pra, vetëm paga e Artanit është më shumë se dyfishi i vlerës së apartamentit që im atë ka blerë në vitin 2010, pa llogaritur të ardhurat pas viti 2010. Bashkëlidhur me këto parashtrime do të depozitohet edhe deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., datë 1.12.2009 e A. I., A. I., F. I. dhe F. I.
- f. Gjithashtu, ju kam vënë në dispozicion një certifikatë familjare, të lëshuar në datën 13.11.2019, nga Njësi Bashkiake Nr. \*\*\* Tiranë, që provon faktin se pasi unë jam ndarë nga trangu familjar në vitin 2007, tre vëllezërit e tjerë kanë vazhduar të jenë në një familje me prindërit, të pa ndarë.
- g. Dokumentacioni që provon se e bija e B., A. I. (motra ime) jeton dhe punon në emigracion në Londër, Angli, bashkë me të shoqin Q. C. Në këto dokumente përfshihet një kopje e pasaportës angleze nr. \*\*\*, Dokumenti i Home Office Immigration and Nationality Directory i datës 24 gusht 2001, me të cilën i është dhënë statusi i azilantes në Angli në datën 27.8.2001. Dokumenti bankar i bankës HSBC, nga ku rezulton se është në marrëdhënie punë dhe paguhet nga kompania \*\*\* LTD (shihni f. 1 dhe statement).
- h. Dokumentacioni që provon se i biri, F. I. (vëllai im), i cili jetonte dhe jeton me Bashkimin në një familje, ka qenë në marrëdhënie pune nga data 1.2.2008 e në vijim pranë AKSHI-t si specialist i IT-së. Gjithashtu, F. ka jetuar për rreth 4 vjet në Londër, Angli, ku ka studiuar dhe punuar në periudhën 2003 – 2007. Gjatë kësaj periudhe ka pasur kursime në 'Intesa Sanpaolo Bank', në llogari të përbashkët me të atin Bashkimin, të cituara më poshtë. Këto prova janë pjesë e dosjes nga përgjigjet e bankave për Komisionin.
- i. Kursime të ndryshme në 'Intesa Sanpaolo Bank' ndër vite, në periudhën deri në fund të vitit 2010, kur është porositur apartamenti. Në këtë bankë, Bashkim Islamaj ka pasur llogari të përbashkët me të birin, F. I., (i cili ka jetuar dhe në Angli për rreth 4 vjet). Nr. llogarie \*\*\*, nga e cila rezulton se ka pasur depozitime dhe tërheqje në vitet 2004 – 2006, në vlerën 17.859 GBP, e cila sipas kursit të këmbimit të kohës është afërsisht në vlerën 3.196.761 lekë. Gjithashtu, rezulton se në këtë bankë me nr. llogarie \*\*\*, B. dhe F. kanë pasur kursime në shumën rreth 12.000 euro, të tërhequra deri në fund të vitit 2010. Këto prova janë pjesë e dosjes nga përgjigjet e bankave drejtuar Komisionit.
- j. Të ardhurat nga pensionet e pleqërisë nga vitet 1998 deri në fund të vitit 2010 për B. I. dhe për bashkëshorten M. I. për periudhën 1997 – 2010, sipas vërtetimeve të datës 13.11.2019, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

k. *Pra, nga të gjitha burimet e cituara më lart me dokumentacionin përkatës, provohen plotësisht burimet e krijimit të shumës 50.000 euro, të shpenzuara prej babait tim për të porositur këtë apartament banimi në adresën: Rr. '\*\*\*' (njohur edhe me emrin '\*\*\*'), kompleksi '\*\*\*', shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*. Është e qartë që nga këto burime të fëmijëve të tij A., F., A. dhe F. I., si dhe kursimet e veta dhe të bashkëshortes, tejkalohet disa herë kjo shumë, edhe duke zbritur shpenzimet e jetesës sipas standardeve të INSTAT-it”.*

#### **Vlerësimi dhe arsyetimi i pakicës**

- xiv. Pas shqyrtimit të materialit të administruar nga Komisioni, lidhur me këtë pikë dhe në vijim të kryerjes së analizës juridiko-financiare të dokumente, provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi burimet financiare që kanë mundësuar krijimin e kësaj pasurie, unë, si anëtar pakice, çmoj se subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë dhe të shpjegojë bindshëm se babai i tij, z. B. I., kishte burime financiare të ligjshme nga të ardhurat e familjes së tij, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të mjaftueshme për pagesën e shumës prej 50.000 euro në shtator të vitit 2010.
- xv. Konkluzioni i mësipërm arrihet pasi u është dhënë përgjigje pozitive disa pikave të shqyrtuara dhe të analizuara në kontekstin e paraqitur përgjatë hetimit administrativ të Komisionit dhe që lidhen pikërisht me kristalizimin e situatës faktiko-ligjore dhe juridiko-financiare të burimeve monetare të familjes së z. B. I., deri në momentin e shpenzimit të shumës prej 50.000 euro (më 23.9.2010) – pika/çështje të cilat do të shtjellohen në vijim dhe që konkretisht konsistojnë në: (i) nëse duhet të përlllogariten të ardhurat respektive të të gjithë anëtarëve të familjes së z. Bashkim Islamaj, sipas certifikatës familjare, pa qenë nevoja e provës së kalimit të shumave monetare nga njëri anëtar i familjes tek tjetri; (ii) nëse z. B. I. ka pasur burime financiare të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer pagesën e shumës prej 50.000 euro në shtator të vitit 2010; (iii) nëse të ardhurat e z. A. I. mund të merren në konsideratë për përlllogaritjet deri në gusht të vitit 2010, pavarësisht faktit që nuk është cituar nga subjekti i rivlerësimit, mes kontribuuesve për pagesën në fjalë, në përgjigjet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2014<sup>6</sup>, por ai është përfshirë dhe deklaruar si kontribuues për blerjen në fjalë disa herë nga vetë z. B. I., nëpërmjet deklaratave noteriale<sup>7</sup> dhe ka qenë anëtar i familjes së këtij të fundit; (iv) nëse z. B. I. do të kishte pasur mundësi financiare të mjaftueshme për të kryer investimin prej 50.000 euro në analizë, edhe pa përlllogaritur të ardhurat e z. A. I. –(duke i konsideruar hipotetikisht si të padisponueshme në vitin 2010).
- xvi. **Lidhur me pikën e parë:** nëse duhet të përlllogariten të ardhurat respektive të të gjithë anëtarëve të familjes së z. B. I., sipas certifikatës familjare, pa qenë nevoja e provës së kalimit të shumave monetare nga njëri anëtar i familjes tek tjetri, vlerësohet se për sa kohë, në këndvështrimin ligjor dhe faktik, bëhet fjalë për një familje, detyrimisht (*ex lege*) Komisioni – përgjatë përpunimit të të dhënave në funksion të përlllogaritjes së burimeve monetare për të verifikuar mundësitë financiare në një moment të caktuar të kryefamiljarit (apo edhe të një tjetër anëtar të kësaj familjeje) – nuk mund të anashkalojë konsiderimin dhe përfshirjen e çdo të ardhure të gjeneruar dhe të provuar në harkun kohor objekt shqyrtimi.
- xvii. Çdo qëndrim ndryshe për përjashtimin e ndonjë prej të ardhurave familjare të dokumentuara, vetëm për faktin se midis familjarëve bashkëjetues nuk është provuar/dokumentuar qarkullimi i shumave monetare që kanë kontribuar në

<sup>6</sup> “Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive”, i mbajtur në datën 30.10.2014, në ILDKPKI.

<sup>7</sup> Nëpërmjet deklaratave noteriale datë 27.9.2016 dhe datë 12.2.2019 me nr. \*\*\* rep.

blerjen e një pasurie (në emër të kryefamiljarit) – pa u bazuar mbi ndonjë provë të kundërt konkrete dhe të qartë (e cila ndoshta mund të mundësonte përjashtimin nga rregulli gjithëpërfshirës i të ardhurave familjare të ligjshme) – do të konsistonte në cungimin dhe pakësimin artificial dhe të padrejtë të totalit të burimeve të një familjeje, të përllogaritura *ex post* – për sa kohë as kryefamiljari (titullari i sendit) dhe as ndonjë tjetër anëtar i familjes nuk ka pasur detyrimin ligjor që t'i deklaronte (burimet financiare të përdorura në shtator të vitit 2010) në vitin e krijimit të pasurisë *de qua*.

- xviii. **Rrjedhimisht, sipas pakicës, të gjitha burimet e ligjshme të gjeneruara nga çdo anëtar i familjes Islamaj, deri në shtator të vitit 2010, që kanë rezultuar të provuara me dokumentacion ligjor, duhet të konkurrojnë në shumatoren e kursimeve të mundshme të familjes, të cilat *de jure* janë bërë pjesë e të mirave të përbashkëta familjare dhe me të cilat është kontribuar në blerjen e apartamentit në fjalë, të përdorur nga subjekti i rivlerësimit.**
- xix. **Lidhur me pikën e dytë: nëse z. B. I. ka pasur burime financiare të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer pagesën e shumës prej 50.000 euro në shtator të vitit 2010, evidentohet fakti se duke marrë në konsideratë vetëm periudhën 2006 – 2010, nga një përllogaritje e shumatores se të ardhurave financiare të provuara me dokumentacion ligjor, duke zbritur shpenzimet jetike për vitet në fjalë, familja e z. B. I., ka pasur burimeve monetare në shumën prej 19.281.737 lekësh, siç janë detajuar në tabelën, si vijon:**

Përshkrimi i të ardhurave, 2006 - gusht 2010	Vlera
Të ardhurat e z. B. I. nga pensioni, 2006 – gusht 2010 Të ardhurat e znj. M. I. nga pensioni, 2006 – gusht 2010	798.532 lekë 809.033 lekë
Të ardhurat e z. F. I. nga shitja në datën 25.7.2006, të 49 % të kuotave të United P.G. (me çmim të pandryshuar <sup>8</sup> nga vlera nominale) Të ardhurat e z. F. I. <sup>9</sup> nga shitja e 51 % e kuotave të datës 16.4.2007, të United P.G. (me çmim të ndryshuar <sup>10</sup> nga vlera nominale)	2.450.000 lekë  64.000 euro ekuiv <sup>11</sup> : 8.091.520 lekë
Të ardhurat e z. F. I. në periudhën 1.2.2008 – 30.8.2010, (30 muaj) sipas vërtetimit nr. ***, datë 18.4.2012, të AKSHI-t.	2.240.000 lekë

<sup>8</sup> Për sa kohë shitja është kryer me të njëjtin çmim (nominal) të kapitalizimit, të pasqyruar në bilancet e shoqërisë, nuk është realizuar ndonjë fitim, për rrjedhojë, nuk ka pasur as detyrime tatimore lidhur me këtë shumë të ardhurash.

<sup>9</sup> Pa i konsideruar të ardhurat e tjera të pretenduara dhe të deklaruara prej z. F. I. si të fituara në Zvicër dhe nga aktiviteti si agjent tregtar në Shqipëri dhe Kosovë, si të ardhura të znj. A. I. të gjeneruara në Angli, për sa kohë nuk janë provuar me dokumentacion të plotë në formën e parashikuar nga ligji (me vulë apostile, të noterizuar dhe të përkthyer në gjuhën shqipe).

<sup>10</sup> Në këtë rast, shitja është kryer me të njëjtin çmim, më të lartë nga ai nominal, të kapitalizimit, që është pasqyruar në bilancet e shoqërisë, dhe për këtë shkak është realizuar një fitim i vlerës së shtuar [64.000 euro – (ekuivalente) 2.450.000 lekë], për të cilat shitësi ka pasur detyrime tatimore lidhur (edhe pse mbetet për t'u parë deri në çfarë pike mund të penalizohet një subjekt rivlerësimi) me mospagimin e tatimeve nga dikush tjetër mbi shuma që në asnjë rast nuk kanë kaluar në favor të subjektit (si dhuratë apo hua). Në çdo rast nga kjo shitje duhet të konsiderohen minimalisht të ardhura prej 5.000.000 lekësh si burim i ligjshëm, për sa kohë kjo ka qenë vlera e kuotave të shitura, shifër deri në të cilën nuk ka pasur detyrim për të paguar detyrimet tatimore.

<sup>11</sup> Kursi i Bankës së Shqipërisë në datën 16.4.2007 rezulton 126,43 lekë.

Të ardhurat e z. A. I. në periudhën 2006 – 2010, sipas vërtetimit të ISSh-së <sup>12</sup>	7.462.674 lekë
Shpenzimet jetike për vitet 2006 – 2010, sipas INSTAT-it	-2.570.022 lekë
<b>Rezultati total (të ardhura – shpenzime jetike)</b>	<b>19.281.737 lekë</b>

- xx. Nga sa më sipër, **rezulton se burimet financiare të ligjshme për familjen e z. B. I., vetëm përgjatë periudhës 2006 – 2010, kanë qenë mëse të mjaftueshme për të mundur dhe përballuar investimin prej 50.000 euro (6.863.500 lekë) nga z. F. I., në kushtet që konstatohet se mundësia e kursimit për familjen e z. B. I., vetëm për periudhën 2006 – gusht 2010 ka qenë 19.281.737 lekë, pra, rreth tri herë më shumë se shifra objekt verifikimi (6.863.500 lekë).**
- xxi. **Lidhur me pikën e tretë:** nëse të ardhurat e z. A. I. mund të merren në konsideratë për përlllogaritjet deri në gusht të vitit 2010, pavarësisht faktit që nuk është cituar nga subjekti i rivlerësimit mes kontribuuesve për pagesën në fjalë, në përgjigjet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2014<sup>13</sup>, por është përfshirë dhe deklaruar si kontribuues për blerjen në fjalë disa herë, nga vetë z. B. I., nëpërmjet deklaratave noteriale<sup>14</sup> dhe ka qenë anëtar i familjes së këtij të fundit.
- xxii. Për sa i përket faktit që subjekti i rivlerësimit, në dëgjuesën e tij në ILDKPKI në vitin 2004, nuk ka përmendur emrin e z. A. I., si bashkëkontribuues familjar për shumën prej 50.000 euro, të investuar në emër të babait në vitin 2010, sipas mendimit të pakicës, kjo rrethanë nuk mund të përjashtojë konsiderimin dhe përlllogaritjen edhe të të ardhurave të z. A. I. brenda vlerësimit të gjendjes së përgjithshme ekonomiko-financiare të familjes së tij, për shkaqet e përshkruara më poshtë:
- Z. A. I. është anëtar i rregullt i familjes, e cila ka si kryefamiljar z. B. I. – siç rezulton edhe nga certifikata familjare përkatëse. Për rrjedhojë, të ardhurat e tij duhet të konsiderohen njëjloj si të ardhurat (e dokumentuara) e anëtarëve të tjerë të familjes – ashtu siç përlllogariten edhe shpenzimet jetike për secilin prej tyre. Përjashtimi i këtyre të ardhurave, pa një shkak ligjor konkret dhe të provuar, nga pasqyrimi gjithëpërfshirës i situatës ekonomiko-financiare të kësaj familjeje do të deformonte realitetin e situatës faktike të konstatuar përgjatë hetimit administrativ.
  - Të ardhurat e siguruara nga puna e z. A. I. në periudhën 2000 – 2010, të provuara me dokumentacion ligjor, rezultojnë jo vetëm të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, por edhe mëse të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve apo investimeve<sup>15</sup> të kryera nga vetë ai deri në vitin 2010 dhe,

<sup>12</sup> Ky dokument i ISSh-së pasqyron të ardhura *neto* akoma më të larta, pasi i referohet periudhës 3.1.2010 – 13.11.2013, por për analizën tonë është marrë në konsideratë vetëm fitimi *neto* i periudhës 2006 – gusht 2010.

Gjithsesi, z. A. I., me totalin e të ardhurave të përfituara prej vitit 2000 deri në vitin 2010 justifikon edhe blerjen e apartamentit të tij, duke i mjaftuar fitimet edhe për të kontribuar në blerjen e apartamentit *de quo* nga babai i tij.

<sup>13</sup> “Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive”, i mbajtur në datën 30.10.2014, në ILDKPKI.

<sup>14</sup> Deklaratat noteriale datë 27.9.2016 dhe datë 12.2.2019 me nr. \*\*\* rep.

<sup>15</sup> Pavarësisht faktit që duke patur parasysh kuadrin ligjor dhe në bazë edhe të jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Komisioni nuk mund të kryej një analizë të mirëfilltë financiare për personat e tjerë të lidhur, duke analizuar burimet për të gjitha shpenzimet dhe pasuritë e tyre, dhe aq më pak për kontribuesit apo personat e lidhur e/të përonave të tjerë të lidhur, por duhet të verifikojë burimin e ligjshëm vetëm për shumën që ka përfutur subjekti. Pra legjitimiteti hetimor ndaj personave të tjerë të lidhur ekziston i përcaktuar vetëm përballë një hetimi/verifikimi të kufizuar dhe të fokusuar eskuzivisht mbi objektin e dhurimit, huadhënies, përdorimit – përtej rasteve përjashtimore që mund të justifikohen nga denoncime specifike apo indicie ose prova mbi fshehjen e mundëshme të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. (Shih vendimet e KPA-së, nr. 15/2019 (JR), par. 110 dhe nr. 34/2019 (JR), par 92.5, në të cilët konfirmohet ky orientim jurisprudencial).

gjithashtu, për të justifikuar/mbuluar edhe kontributin e dhënë për blerjen e apartamentit *de quo* nga babai. Madje, disponibiliteti i tij financiar do të mjaftonte për justifikimin e të gjithë shumës në analizë (6.863.500 lekë ose 50.000 euro).

- c. Përmbajtja e përgjigjeve të z. Fatri Islamaj në vitin 2014 dhe mos citimi në to të emrit të z. A. I. nga subjekti i rivlerësimit, si njëri prej kontribuesve për blerjen në fjalë, nuk mund të ketë një vlerë provuese më të madhe se deklarimet përpara noterit të bëra nga vetë z. B. I., - i cili nuk ishte pyetur më herët lidhur me burimet që i kishin mundësuar investimin e shumës prej 50.000 euro në vitin 2010. Nuk mund të mendohet apo prezumohet se subjekti i rivlerësimit e njihnte më mirë realitetin financiar të familjes së z. B. I., ku ky i fundit ishte kryefamiljar. Rrjedhimisht, nuk mund të ndëshkohet subjekti i rivlerësimit për një pasaktësi (për mosnjohje, harresë apo lapsus) të kryer në rrethana të veçanta mbi burimet e të ardhurave të një tjetër familjeje. Ky fakt nuk mund të ketë një vlerë provuese më të madhe se deklarimet noteriale të bëra mbi këtë pikë, për sa kohë z. B. I. nuk ka qenë subjekt deklarues dhe nuk është shprehur më herët mbi burimet e të ardhurave në fjalë.
- d. Në rastin konkret, nuk jemi përballë mungesës së përputhjes (totale) midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në kohë të ndryshme, por jemi midis deklarimit të subjektit mbi të ardhurat e një tjetër familjeje dhe deklarimit të mëpasshëm të kryefamiljarit të kësaj të fundit. Për logjikë analitike, mendohet se deklarimet e z. B. I., në këtë rrethanë vlejné më shumë se përgjigjet e subjektit, për sa kohë ai është kryefamiljari i familjes në fjalë, dhe prezumohet se i njeh më mirë elementet përbërëse të të ardhurave të familjes së tij.
- e. Për sa më lart, nuk jemi përballë ndryshimit të burimit financiar nga subjekti (në ndonjë deklarim ndryshe të mëpasshëm të tij) lidhur me të ardhura të familjes apo investimit të vet, por bëhet fjalë për saktësimin dhe shtimin edhe të një tjetër (emri) anëtarë të familjes, pra, pa e zgjeruar rrethin e burimeve jashtë perimetrit të familjes, të pasqyruar në çertifikatën familjare dhe pa i zëvendësuar burimet e cituara më herët, por thjesht duke i konfirmuar dhe i saktësuar ato.
- f. Për sa kohë nuk jemi përballë një ndryshimi thelbësor apo zëvendësimi total të një burimi financiar të deklaruar dhe modifikuar/ndryshuar, nga vetë subjekti (për të ardhurat e familjes së tij) apo edhe nga personi i lidhur, që me deklarimet e mëpasshme mund të binin në kontradiktë me vetveten, në këtë rast nuk shihen as probleme lidhur me deklarimet e pasurisë (për sa kohë kanë qenë autonome dhe nga persona të ndryshëm) dhe as shkaqe për të përjashtuar nga përlllogaritja burimin e të ardhurave të ligjshme të fituara nga puna e z. A. I., deri në vitin 2010.
- g. Përkundrazi, referuar dispozitave ligjore përkatëse, përjashtimi nga analiza e një të ardhure financiare të provuar me dokumente ligjore dhe të gjeneruara nga njëri prej anëtarëve të familjes (për të cilën kryhet verifikimi i mundësive financiare), në këndvështrimin e pakicës, nuk do të çonte në një rezultat apo konkluzion të drejtë në raport me konstatimet e hetimit administrativ. Ky konkluzion arrihet nga leximi dhe aplikimi i frymës së dy dispozitave ligjore, të kombinuara edhe me rregullimet kushtetuese përkatëse dhe të ndërthurura midis

---

Për më tepër, në rastin konkret, nuk jami përballë detyrimit të subjektit për justifikimin e një shume specifike monetare të dhënë hua, apo të dhuruar në favor të tij. Kjo rrethanë e zbeh akoma më shumë mundësinë e penalizimit të mundshëm të subjektit të rivlerësimit, thjeshtë dhe vetëm për faktin se ai ka përdorur sendin e dikujt tjetër, edhe në rast se personi tjetër i lidhur - pronari legjitim i këtij sendi, - do të rezultonte me një mungesë të vogël burimesh financiare të ligjshme, për krijimin e tij (sendit), në raport me vlerën/koston totale të kësaj pasurie.



tyre. Konkretisht, sikurse neni D i Aneksit të Kushtetutës, edhe ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, dhe ligji nr. 84/2016<sup>16</sup> parashikojnë konsiderimin e të ardhurave si të ligjshme, për sa kohë janë gjeneruar brenda rrethit familjar të subjektit (përtej huave dhe dhurimeve), janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

- h. Këto dispozita, në asnjë moment nuk i ndajnë burimet e anëtarëve të familjes nga të ardhurat e kryefamiljarit, por i konsiderojnë si burim financiar të mundshëm për subjektin e rivlerësimit çdo të ardhur që është gjeneruar nga secili prej anëtarëve të familjes së tij (të pasqyruar në certifikatën e gjendjes civile përkatëse). Për analogji, edhe mundësia financiare e një personi tjetër të lidhur duhet të bazohet dhe të përllogaritet mbi totalin e të ardhurave të gjeneruara nga çdo anëtar i familjes së tij, pasi ky burim të ketë rezultuar i ligjshëm në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, me të vetmin ndryshim që në këtë rast deklarimi i burimit nuk ndikon në vlerësim, për sa kohë personi tjetër i lidhur nuk ka pasur detyrimin ligjor dhe as mundësinë për të deklaruar burimet e përdorura për krijimin e një pasurie.
  - i. Deklarimi i paplotë i subjektit të rivlerësimit në vitin 2014, mbi një burim (dhe pasuri) jo të vetin, por të një tjetër personi, nuk mund të afektojë dhe të përjashtojë këto të ardhura të ligjshme, pasi vetë përfituesi (A. I.), si dhe përdoruesi i tyre (B. I.) e kanë pohuar dhe konfirmuar këtë rrethanë në të gjitha deklaratat e tyre noteriale. Për rrjedhojë, të ardhurat e fituara nga puna e z. A. I. duhet të merren në konsideratë, për sa kohë plotësojnë të gjitha kriteret ligjore – përfshirë këtu edhe dispozitën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- xxiii. **Për sa më sipër, të ardhurat e gjeneruara nga z. A. I., në vlerësimin e pakicës, i kënaqin kriteret ligjore për t’u konsideruar si një burim financiar i ligjshëm e kontribues në ekonominë familjare dhe, për rrjedhojë, shumat e fituara prej tij ishin legjitimisht të përdorshme nga z. B. I. (kryefamiljar), në vitin 2010.**
- xxiv. **Lidhur me pikën e katërt: nëse z. B. I. do të kishte pasur mundësi financiare të mjaftueshme për të kryer investimin prej 50.000 euro në analizë, edhe pa përllogaritur të ardhurat e z. A. I. (duke i konsideruar hipotetikusht si të padisponueshme në vitin 2010).**
- xxv. Nisur nga shifrat dhe rezultatet e pasqyruara në tabelën e mësipërme (në pikën e dytë, paragrafi xvii), konstatohet se, edhe duke zbritur shumat e fituara nga puna e z. A. I. (së bashku me shpenzimet jetike për një person), z. B. I. dhe familja e tij do të mund të përballonte shpenzimin e shumës prej 50.000 euro në shtator të vitit 2010, për sa kohë mundësia financiare do të rezultonte shumë më tepër se kjo shifër [(total të ardhura) 21.851.759 – 7.462.674 (të ardhurat e z. A. I.) = 14.389.085 – 1.927.517 (shpenzimet jetike për një person më pak) = 12.461.568 lekë].
- xxvi. Gjithashtu, edhe nëse do të bëhej një përllogaritje e burimeve të ligjshme *neto* të z. Bashkim Islamaj në shtator të vitit 2010, në një këndvështrim akoma më të ngushtë, duke mos konsideruar as të ardhurat e z. A. I. dhe as vlerën e shtuar nga shitja e kuotave të shoqërisë “\*\*\*” nga z. F. I., në vitin 2007, gjithsesi do të rezultonte një disponibilitet financiar i mjaftueshëm për pagesën e shumës prej 50.000 euro nga burime të ligjshme të dokumentuara: [12.461.568 lekë (*mundësia e kursimeve neto pa të ardhurat e z. A. I.*) – 5.541.520 lekë (*vlera e shtuar*<sup>17</sup> - në vitin 2007, kur u

<sup>16</sup> Përkatësisht ligji nr. 84/2016, pika 13 e nenit 3, dhe nenet 32 e 33, trajtojnë së bashku si deklarimet e pasurive, ashtu edhe të të ardhurave të familjarëve të subjekteve dhe për analogji ky kriter përllogaritjeje duhet të aplikohet edhe për të ardhurat familjare të një personi tjetër të lidhur.

<sup>17</sup> Nëse do të hipotetizojmë mospagimin e tatimeve mbi vlerën e shtuar, vlera e kapitalit prej 5.000 lekësh (e patatueshme) është pa dyshim një burim i ligjshëm.

shitën 51 % e kuotave të shoqërisë “\*\*\*.” nga z. F. I.) = 6.920.048 lekë]. Ndërkohë që ekuivalenti i shumës 50.000 euro në shtator të vitit 2010, siç u përmend edhe më sipër, përkon me shumën prej 6.863.500 lekësh. Për rrjedhojë, nga të gjitha alternativat e përlllogaritjes së burimeve financiare të familjes së z. B. I. rezulton se, ky i fundit kishte burime financiare për të përballuar pagesën e shumës prej 50.000 euro, në shtator të vitit 2010 për apartamentin e banimit të përdorur nga subjekti i rivlerësimit në adresën: Rr. “\*\*\*”/“\*\*\*”, kompleksi “\*\*\*”, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, Tiranë.

- xxvii. **Në këto kushte, pakica çmon dhe konkludon se lidhur me përdorimin e këtij apartamenti, për sa kohë rezulton se ai është blerë me burime financiare të ligjshme, nuk ka asnjë shkak për penalizimin dhe shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.**

### **Lidhur me deklaratimet e subjektit**

Ndryshe nga vlerësimi i shumicës, të shprehur në konkluzionet për rubrikën e vlerësimit të pasurisë (në f. 35 të vendimit), pakica çmon se nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk kanë rezultuar deklaratime<sup>18</sup> të pamjaftueshme të subjektit të rivlerësimit, të cilat mund të çonin në aplikimin e një mase disiplinore ndaj tij, parë kjo edhe në përpjesëtim me peshën specifike të pasaktësive të konstatuara<sup>19</sup> dhe brenda kornizës së parimit të proporcionalitetit. Ky konkluzion i pakicës buron nga një vlerësim i përgjithshëm i këtij procesi rivlerësimi, nëpërmjet një analize objektive të konstatimeve të Komisionit, nën dritën e kuadrit ligjor specifik dhe orientimeve jurisprudenciale, dhe konkretisht bazohet në situatën faktike dhe ligjore, si më poshtë vijon:

- a. Subjekti ka provuar me dokumentet ligjore që ka paraqitur në Komision dhe ka shpjeguar bindshëm të gjitha pikat e barrës së provës që i ka kaluar, përfshirë edhe burimin e ligjshëm për çdo pasuri dhe të drejtë reale që subjekti dhe familja e tij ka zotëruar dhe/ose zotëron.
- b. Mosdeklarimi i llogarisë bankare dyemërore, me nr. \*\*\* (e bashkëshortes së subjektit bashkë me të vëllanë<sup>20</sup>), në “Intesa Sanpaolo Bank” nuk mund të përbëjë një pamjaftueshmëri, por një pasaktësi (rrethanë të cilën subjekti e ka shpjeguar bindshëm në prapësimet e tij). Ky përfundim i pakicës arrihet duke pasur parasysh edhe disa elemente të tjera që plotësojnë dhe qartësojnë panoramën dhe dinamikën e fakteve në fjalë, të cilat shkurtimisht citohen në vijim:
  - b.1 Kjo llogari rezulton e hapur disa vite përpara martesës së znj. M. I. me subjektin e rivlerësimit dhe nuk është e provuar dijenia e tij mbi ekzistencën e kësaj llogarie, për sa kohë nuk rezulton të jetë përdorur ndonjëherë prej tij dhe pas datës 10.3.2008 nuk janë kryer më veprime bankare as nga bashkëshortja e tij.
  - b.2 Në këtë llogari znj. M. I. ka kryer gjithsej vetëm katër derdhje<sup>21</sup>, me gjendje të papërfillshme monetare, në raport me të ardhurat e tyre.

<sup>18</sup> Sipas pakicës as deklarimi i pasaktë/paplotë i burimeve të një personi tjetër (në vitin 2014) dhe as mosdeklarimi i adresës në DIPP 2011-2013, nuk mund të përbëjnë deklarim të pamjaftueshëm dhe për rrjedhojë nuk mund të pasjellin në rastin konkret aplikimin e nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84.2016.

<sup>19</sup> Konkretisht: mosdeklarimi i adresës në disa DIPP; mos citimi i të gjitha emrave të kontribuesve për personin tjetër të lidhur dhe mosdeklarimi i llogarie dyemërore që do të analizohet në vijim.

<sup>20</sup> Znj. M. L. dhe z. A. L..

<sup>21</sup> Veprimet bankare të vetme të kryera nga Banka e Shqipërisë kanë konsistuar në tri derdhje modeste (para martesë): 90.415 lekë (më 14.8.2006); 40.000 lekë (më 20.11.2006); 20.000 lekë (më 10.7.2007) dhe 10.000 lekë (më 10.3.2008) për pagesën e qirasë (sipas shpjegimeve të subjektit).

b.3 Nisur nga fakti që rreth 9 vite përpara deklaratës “Vetting”, kjo llogari nuk rezulton të jetë përdorur nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit dhe, për sa kohë ajo (personi i lidhur) nuk e ka deklaruar këtë llogari në deklaratën e parë pas martesës dhe as në deklaratën “Vetting”, kombinuar me rrethanën e gjendjes në shuma minimale, çdo analizë logjike do të çonte në përfundimin e një harrese të kësaj llogarie dhe jo në prezencën e një mosdeklarimi të vetëdijshëm prej saj.

b.4 Për më tepër, vetë subjekti nuk e ka përdorur ndonjëherë këtë llogari dhe nuk është provuar që subjekti e njihte këtë rrethanë, madje ai ka mohuar të ishte në dijeni, duke pohuar se në të kundërt nuk do të kishte pasur arsye për të mos e deklaruar atë.

b.5. Llogaria *de qua* – sipas shpjegimeve të subjektit – është hapur nga bashkëshortja e tij, së bashku me vëllain e saj, për shkakun se ky i fundit si dhe prindërit e tyre jetonin jashtë shtetit, duke krijuar një komoditet patja e aksesit në këtë llogari nga një familjar që jetonte në Shqipëri. Për më tepër, në këtë llogari transferohej/derdhej pensioni i babait të tyre – rrethanë kjo e verifikueshme edhe nga statmentet bankare.

Për rrjedhojë, në mungesë të një përfshirjeje direkte të z. Fatri Islamaj në këtë fakt dhe në pamundësi të konstatimit të dijenisë së tij, subjekti nuk mund të penalizohet për shkak të mosdeklarimit të një llogarie dyemërore (me gjendje të papërfillshme të personit të lidhur, të hapur para martesë) që gjithsesi, nën një këndvështrim proporcionaliteti do të ishte një mangësi/pasaktësi e tolerueshme dhe jo e mjaftueshme për aplikimin e një mase disiplinore.

- c. Subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokumentet ligjore të paraqitura në Komision, burimin e ligjshëm<sup>22</sup> që ka shërbyer për blerjen e pasurisë<sup>23</sup> (apartamentin e përdorur prej tij), në pronësi të personit tjetër të lidhur, - pasi i është kërkuar nga Komisioni. Subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri, për sa kohë ka deklaruar saktë adresën e banimit dhe nuk mund dhe nuk duhej të deklaronte, përpara procesit të rivlerësimit lidhur me burimet e përdorura për këtë blerje. Deklarimi i bërë në vitin 2014 në ILDKPKI, bazuar në njohuritë e tij, përbën një rrethanë të veçantë (*pre vetting*), me efekte lehtësuese, për sa kohë subjekti nuk përgjigjej për pasurinë dhe të ardhurat e tij dhe, për rrjedhojë, pasaktësia e mundshme në to, nuk mund të përbëjë një deklaram të pamjaftueshëm, me pasojë aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**xxviii. Nga sa më lart, pakica arrin në përfundimin se pasaktësitë e deklarimeve të përshkruara (dhe të argumentuara edhe nga shumica në këtë vendim), nuk janë me një peshë specifike të tillë që të krijojnë bindjen se ato në vetvete mund të përbëjnë shkak për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, të parashikuar nga pika 3, e nenit 61, e ligjit nr. 84/2016, pasi kjo masë, në vlerësimin tim, do të rezultonte tejet e ashpër, jo në raport të drejtë me faktet e provuara dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit.**

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe në metodologjinë e rivlerësimit për këtë kriter, të përshkruar më sipër, unë, si anëtar në pakicë/kundër, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshme në lidhje me kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

<sup>22</sup> Siç është analizuar dhe arsyetuar në paragrafët e mësipërm të këtij mendimi pakice.

<sup>23</sup> Apartament banimi në adresën: Rr. “\*\*\*\*” (njohur edhe me emrin “\*\*\*\*”), kompleksi “\*\*\*\*”, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Unë, si anëtar në pakicë, vlerësoj se vendimi i shumicës së trupit gjykues, që ka shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, nuk është i drejtë, pasi çmoj se i ka përmbushur të tria kushtet e parashikuara në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

**Për arsyet e sipërcituara, sipas parashikimeve të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në provat që disponon Komisioni, në përgjigjet e subjektit dhe në deklaratimet e bëra prej tij në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Fatri Islamaj, ka arritur një nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë dhe të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Për rrjedhojë, krijohet bindja se shumica nuk duhet të kishte disponuar shkarkimin nga detyra të këtij subjekti, por konfirmimin e tij në detyrë.**

**Anëtar në pakicë/kundër  
Lulzim Hamitaj**

*Sekretare gjyqësore  
Anisa Duka*